

VITI XVII, NUMRI 1 / JANAR 2013

FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA

Happy New Year! 2013





Si do ta përcaktonit këtë fjalë?

Shkrimtarë, filozofë apo burra shteti gjatë shekujve janë përpjekur ta shpjegojnë se cilat janë ato gjëra që një lider e bëjnë të madh. Për mua ky është një parim i rëndësishëm, prandaj dhe në Super Rally-in e fundit ne folëm për leadershipin si një nga katër elementët bazë për ndërtimin e një biznesi të sukseshëm në Forever. Kohët e fundit kam lexuar një shkrim në revistën Forbes për një drejtues fantastik – për trainerin Vince Lombardin.

Lombardi në vitet 60-të, si drejtues i skuadrës amerikane të futbollit Green Bay Pecker, fitoi tre herë kampionation Super Bowl. Ndërkohë që ai fitoi famë si një nga trainerat kërkues të fortë dhe që nuk e njihte të pamundurën, ai kishte dhe një anë të veçantë të kujdesit për lojtarët. Një nga lojtarët e tij ka theksuar: „Jashtë familjes nuk më ka dashur njeri tjetër aq sa ai. Ne e dinim se ai bënte gjithshka për ne... gjithshka. Për atë njeri ne hidheshim në flakë”

Prandaj gjatë viteve të eksperiencës time me Foreverin, unë kam pyetur veten: cilat janë ato cilësi që duhet të ketë një drejtues i madh? Si mund të vazhdojmë të frymëzojmë një sukses të tillë të mrekullueshëm në të gjitha nivelet e kompanisë sonë? Unë kam vërtetuar tre strategji të provuara që unë i kam parë si të përbashkëta për të gjithë ata që unë i quaj „drejtues të nivelit të lartë”:



Drejtuesi i nivelit të lartë

Shembulli personal:

Unë kam parë se „drejtuesi i nivelit të lartë” drejton më shumë me shembullin personal sesa vetëm me fjalë. Bëni një listë të karakteristikave që doni të kenë ata që drejojnë poshtë jush. Ato janë: marrja përsipër e përgjegjësisë, inkurajimi i suksesit tek të tjerët, të punuarit me objektiva dhe përqaftimi i ideve për ndryshim. Duhet kohë të vlerësoni sjelljen tuaj dhe të sigurohi që veprimet tuaja përputhen me ato që kërkoni nga të tjerët. Udhëheqja me shembullin personal është një nga mënyrat më të mira për të motivuar të tjerët dhe për të fituar respektin e tyre. Kur të tjerët shikojnë shembullin dhe kënaqsinë tuaj, edhe ata do të punojnë fort për ta arritur atë.

Jepu pushtet të tjerëve

Filozofi i madh kinez, na ka mësuar se „udhëheqësi më i mirë është ai kur njerzit zor se e dinë se ai ekziston, kur puna i bëhet, qëllimi i realizohet, dhe ata thonë: ne e bëmë vetë pa njeri mbi kokë” Ndërkohë njerzit kënaqen dhe shpesh mbështeten tek drejtuesi, ata do të ndërtojnë një biznes më të sukseshëm, kur kanë besim në zotësinë dhe aftësitë e tyre. Çelësi qëndron në atë që të krijosh një mjedis inkurajimi si për suksesin dhe për marrjen përsipër të riskut, edhe kur këto risqe nuk ekzistojnë. Jepu pushtet, frymëzo, motivo ata me të cilët punon, përmes vlerësimit dhe lavdërimit konsistent dhe shiko rezultatet!

Trego dashuri

Ndoshta testi më i mirë i drejtimit në nivelet e tjera, është aftësia për të treguar mirësi dhe dashuri ndaj të tjerëve. Kohët e fundit kam lexuar një libër nga lektori i dëgjuar Harvey Mackay, i cili ka intervistuar shumë vetë nga ata që janë flakur nga puna, por që mposhtën vështirësitë dhe u bënë drejtues të sukseshëm. Mackay citon në librin e tij një bisedë me kryetarin e bashkisë të New Yorkut Michael Bloomberg, i cili është shprehur se ai nuk do ti harrojë kurrë ata njerëz që e kanë kërkuar, për ti mbajtur frymën lart edhe kur ai ishte në nevojë. Drejtuesit e mëdhenj e dinë instikivisht, se dashuria ndaj të tjerëve jep më shumë rezultat se sa qëndrimi i ashpër. Të tregosh kujdes ndaj të tjerëve, është një nga mënyrat më të mira për të motivuar ata.

Jam shumë krenar për gjithë drejtuesit tanë të mëdhej të Foreverit dhe për përpjekjet e tyre të mëdha për të realizuar ndryshime të rëndësishme në shëndetin dhe prosperitetin e të tjerëve. Duke filluar këtë vit të ri unë ju siguroj se çdo njeri nga ju do të vazhdojë të gjejë rrugët për zhvillimin e aftësive drejtuese për tu bërë një drejtues i një niveli të lartë. Unë ju garantoj se duke përqaftuar katër parimet kryesore të FLP: të gjetjes të njerzve, të durimit, të rendimentit dhe të aftësive drejtuese, ato do të kenë një ndikim të jashtëzakonshëm tek ju personalisht, tek biznesi juaj dhe tek linja poshtë jush. Mendoj se së bashku, vitin 2013, do të mund ta bëjmë një nga vitet më të sukseshëm në historinë e Foreverit.


I JUAJI
REX MAUGHAN





Me kuriozitet e pritëm vitin 2013 edhe për shumë arsye, në radhë të parë u vërtetua, që bota nuk u shkatërrua, dhe ne, foreverat do të jemi ndërtuesit bazë të këtij viti të ri.

Forever International në fund të 2012 shpalli, Fushatën e re të Dimrit 2013, sipas së cilës në rradhë të parë shpërblehen ato rezultate, të cilat ju drejtohen sponsorizimit të bashkëpunorëve të rinj, si dhe blerjeve në muajt janar, shkurt. Kështu kush ka distributor të ri me vlerë blerje 4cc, merr të drejtën e futjes në një nga Ditët e Suksestit, ndërsa atë që ka mbi 16cc e presim edhe me drekë dhe fjetje. Kjo është pothuaj e pabesueshme, kështu po e nisim 2013, në historinë e FLP-s nuk ka patur kurrë një program kaq të shquar! Pas një viti fantastik Rex Maughan dhe Gregg Maughan gjetën për ne dhurata të reja, dhe ka se për kë të bëjmë tifozllëk në vitin e ardhshëm. Në rradhë të parë mund të brohorasim për diamant menaxherin Miklós Berkics; që po organizon një trajnim fantastik për diamantët – po përgatitemi për një pjesëmarrje të plotë në trajnimin më të madh të Foreverit hungarez dhe rajonit sllavo-jugor. Bëjmë tifozllëk edhe për diamant menaxherët Attila dhe Kati Gidófalvi, që nga Hawaii të sjellin medaljen e ndritur në kategorinë e Chairman's Bonus. Mundësisht të artë, sepse Katika dhe Attila na kanë lënë gojëhapur me rezultatet e deritanishme. Brohorasim më tej për Veronika dhe Stevan Lomjanski, të parët diamant menaxherë, që të sjellin sa më shumë të kualifikuar në vendin e ri të zhvillimit të këtij aktiviteti, dhe në Opatij, ku do të organizohet Holiday Rally i 2013-ës. Natyrisht që shumë vetë punojmë, që të realizohet ajo çfarë ëndërroi në Hungari safir menaxheri József Szabó, dhe ky rajon të mos jetë vetëm faktor përcaktues në kampin e madh europian të Foreverit, por edhe ta udhëheqi përsëri atë. Për këtë është i nevojshëm një bashkpunim gjigant. Në këtë grup ekziston forca, ndërsa lloji i ri i trajnimeve do të shtojnë më tej entuziazmin dhe do të na japin energji të reja, dhe me këto do të jemi të aftë për të arritur rezultatet më të larta në të gjithë kohët në vitet në vazhdim. Për ty, që për herë të parë merr në dorë revistën e Foreverit, të jap si mesazh: se do të dish të kontribuosh në ngritjen ekonomike të vendit, në mirëqënien e familjes dhe në ruajtjen e shëndetit, nëse do të bësh atë, që të thotë SPONSORI YT. Forca gjendet në këtë mirëkuptim dhe besim, e cila çdo ditë, hap pas hapi, çon përpara idenë, që ëndërroi para tridhjet e pesë vjetëve Rex Maughan. Le të jemi edhe ne realizuesit e kësaj ëndrre! Uroj, që viti 2013 të jetë për të gjithë i qetë, me paqe dhe pasuri. Vitet e fundit Foreveri e ka treguar tashmë, se ka tridhjet e pesë vjet në botë, dhe për afër gjashtëmbëdhjet vjet këtu në territoret e Europës Qendrore, që me miliona njerëz mundën të përjetojnë efektet bamirëse të produkteve tona, dhe përfitimet ekonomike të sistemit tonë të marketingut. 2013 do të jetë viti i veprimt; prandaj duhet vepruar, që të mbetesh në këmbë, që të zgjerohesh dhe që të mund të krijosh lumturinë e familjes tënde.



I uroj të gjithë bashkëpunorët tanë forevera dhe
forevarat e ardhshëm: Gëzuar vitin e ri!
Përpara FLP!

DR. SÁNDOR MILESZ
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

BUDAPEST 15 DHJETOR 2012.

Success Day

Ndoshta nuk e kemi mbyllur kështu një vit këtu në Forever, që të përjetojmë kaq ndryshime, sa tani. Secili fsheh një mundësi të re, një perspektivë më të madhe. 2013 nga përmasat do të jetë një vit tjetër, viti i revolucionit, viti i një zhvillimi të pathyeshëm, ndërsa ata që janë model janë gjithnjë e më të shumtë. Me disa nga ata do të takohemi përsëri në këtë përshkrim.



Këtë Ditë Suksesi të mbylljes së vitit hap me këngën e krishtlindjeve violinisti **Ferenc Sántha** dhe orkestra e tij. Pas demonstrimit të menaxherëve dhe menaxherëve drejtues, këndon kori Bolyki Soul and Gospel bashkë me **Lajos Túri** (Lui). Pas kësaj kemi jo dy por katër drejtues programi: mjeken anesteziste **Edit Révész Siklósné**, specialiste e terapisë intensive, kryetare e grupit të mjekëve specialistë të Foreverit dhe bashkshorti **Zoltán Siklós** (dhjetë vjet në pozicion kryesor në Forever) dhe në krah vajzat e tyre: **Barbara** dhe **Petronella**. Për ato nuk është i huaj ky publik, sepse mund të themi që ato kanë lindur në këtë biznes. Prindërit e tyre janë prej 14 vjetësh rrjetndërtues dhe tashmë janë soaring menaxherë. „Ky është një biznes i tillë, që bazohet në ndihmën dhe dashurinë e të tjerëve“ – përcillet në takimin festiv. **Dr. Sándor Miliesz** – stujuesi kimist, mjek natyralist, zafir menaxher, drejtor i përgjithshëm, na bëri të njohur se biznesi i Foreverit është përsëri në rritje: „Është fantastike ajo që keni arritur në periudhën që shkoi!“



Rezultati më i fundit është studimi profesional, në bashkëpunim me Universitetin e Debrecenit për aftësitë antibakteriale të Aloe veras, ku studimin e ka botuar edhe revista profesionale më e madhe botërore e imunologjisë, që do të thotë një vlerësim shkencor i nivelit më të lartë.

Dr. Sándor Milesz, shpreh falnderimet **József Szabó**-s që „ka luftuar bashkë me të gjithë këta vite” si dhe **Miklós Berkics**-in „një nga rrjetndërtuesit më të shkëlqyer të botës”, pastaj në skenë thërret anëtarët e Klubit të presidentit dhe i falnderon ata për punën e bërë gjatë këtij viti. Klubi i 2012 plotësohet edhe me përfaqësuesit e dikurshëm të forumit të konsulencës. Drejtori thekson se puna në të ardhmen do të vazhdojë me një strukturë tjetër të zgjeruar: „për këtë kemi krijuar projekte fantastike, që Foreveri të mbetet e fuqishme. Ju uroj festa të bekuara dhe një vit të ri të gëzuar!

Është një zakon i bukur i FLP që në fund të vitit përgatit dhurata për fëmijët, por mbasi tregojnë „përvojën e tyre me produktet”, dmth, se çfarë produktesh të Foreverit konsumojnë dhe sa e ndjejnë efektin e tyre. Këtë pjesë drejtojnë tradicionalisht **Dr Terézia Samu**, mjeke specialiste e venave, e cila prej 15 vitesh është ndërtuese e rrjeteve, është konsulente zyrtare e FLP dhe bashkë me të shoqin **András Bruckner**, luajnë rolin e plakut të vitit të ri si soaring menaxher. Për këtë i ndihmojnë edhe nipërit e tyre, **Áron** dhe **Adél Soltó**. „Këta janë brezi i ri. Në qoftë se i mësoni fëmijët tuaj, që konsumi i këtyre produkteve të bëhet pjesë e jetës së përditshme, atëherë ata do të rriten të shëndetshëm” – thotë Terézia Samu. Ndërsa fëmijët rreshtojnë pranë mikrofonit: royal jelly, propolis, vaj peshku, berry, hudhër, echinacia, xhel ... Pas kësaj vazhdon kualifikimi i supervisorëve dhe i asistent menaxherëve: janë radhë të gjata të atyre që i kanë arritur këto nivele.



Nëntëmbëdhjet vjeçari **Bence Halmi**, si fëmi i prindërve menaxher të FLP, ka hyrë shumë i ri në këtë komunitet. Studenti i ekonomikut në Universitetin e Miskolcit mezi priste të mbushte 18 vjeç që të fillonte ndërtimin e biznesit të vet. E kishte si endërr që të ishte menaxheri i 17-të i prindërve të vet, për ti çuar edhe ata në nivelin e diamant menaxherit. Në mbarim të universitetit edhe ai do të arrijë soaring menaxher, dhe sikurse shprehet, nuk do të ndalet deri tek diamanti. „Ishte një një ndjenjë e veçantë kur shikoja mamin dhe babin të ngjiteshin në skenë, por edhe unë kisha shumë dëshirë të ngjitesha aty. Që fëmi kisha qejf të ndërtoja një biznes të madh. Të martën mbusha 18 vjeç, të enjten fillova prezantimet dhe brënda 3 muajsh u bëra supervisor.” Forca e madhe e Bences, qëndron në atë që ato që ka dëgjuar nga të prindërit e tij, është i aftë „ta përkthejë” në gjuhën e të rinjve. Kishte një vizion që më 31 Gusht të arrinte nivelin e menaxherit. Por... për mua nuk kishte rëndësi që unë të arrija dikur menaxher, por të isha unë menaxheri i 17-të.” Endërra u bë realitet, dhe ky objektiv u arrit vetëm me ndihmën e skuadrës së vet.

Tre tenorët e FLP **Miklós Berkics, Tibor Éliás dhe Lajos Túri Lui** ngjiten në skenë me një program festiv, pastaj jashtë programit, si një mik surprizë, ngjitet në skenë diamant menaxheri më i shpejtë në botë **Attila Gidófalvi**, i cili së pari falnderon sponsorin e tij Miklós Berkics dhe kërkon ndihmën e tij edhe për dekadat e ardhshme. „Unë këtë biznes kërkoja, kisha analizuar gjithë sipërmarrjet MLM dhe munda të vendos: ky biznes ia vlen ta bësh. Të arrish 2 milion forinta në muaj pa bërë ndonjë

investim, kjo është mundësia më e mirë” – shprehet ai. „Për një xhiro të njëjtë, kjo firmë të paguan më shumë para, prandaj unë jam këtu. Edhe ti je në vendin e duhur, por ti tash mendon se do të më vijë rasti. Njeriu duhet ta kuptojë që mund ta bëjë diçka dhe deri ku do arrijë. Ia vlen ta bësh, por mos mendo se do vijë vetvetiu. Në qoftë se ti e ke fiksuar në kokën tënde edhe rasti do të vijë. Por njeriu duhet ta ndjejë që mund ta bëjë diçka dhe deri ku do shkojë. Ja vlen ta bësh këtë punë, por në qoftë se nuk ke besim në vetvete, do ta marrësh për asgjë. Në qoftë se nuk ke ecur me temp të tillë si do të doje, mos u mërzit, edhe të tjerët ecin në atë rrugë, dhe në fund askush nuk pyet sa kohë të është dashur.”



Sipas Attila Gidófalvi-t shumë mendojnë, se në nivelin e tij tashmë mund të ndalosh. „Ndoshta do të ndaloja, por nuk të lënë njerzit” – shpjegon ai. Këtë biznes nuk mund të bësh sikur e menaxhon, por duhet të jesh motorri i tij. Atë që prezanton, ajo do të kopjohet. FLP është një nga tre firmat më të mëdha në botë në sistemin MLM, dhe prodhuesi më i madh i Aloes. Pra ke një markë prodhimi, por kur fillon, krahas saj do të duhet të krijosh emrin tënd. Ndjeje ritmin e këtij biznesi, ndjeje veten mirë brenda tij, puno fort.”

Kualifikime të reja: ata me mbi 60 pikë, Klubi Conquistadorëve, menaxherët, të kualifikuarit e programeve stimulues të autoveturës dhe menaxherët drejtues – në skenë qëndrojnë njerëz të tillë, që mund të ishin edhe thjesht konsumatorë, por që dikush që pati besim tek ata. Dhe ata tregojnë se si mund të gjënden perlat, një formë interesante e ndjekjes në det. „Kaluan pragun e lirisë”. „Gjithmonë besoja tek toto lloja, por gjetëm Foreverin.” Dëgjojmë thëniet e a atyre të sapo kualifikuar. Tregojnë se pa gjithkënd nuk do të ishin këto rezultate, pastaj urojnë, një vit të ri të begatë në pikë. **György Csuka dhe Dr Ibolya Bagoly** arritën nivelin e soaring menaxherit. „Premtuam dhe e arritëm nivelin e soaring menaxherit – thotë Ibolya, arritjet e mija na

sigurojnë se do të na kopjojnë. Mëso se si për 2 muaj të nxjerrësh supervisor nga ata

që të thanë po – kështu e filluam. Ndërsa tashmë këtu ke mall të ri: duhet

të tërheqësh menaxherin për soaring, që të prodhosh vlerat e duhura,

tashmë për këtë punojmë. Jam krenare për çdo pjeshtar të veçantë të

skuadrës time. „2013 le të jetë edhe viti juaj!” Pas historive të ndërtimit

të biznesit, tashmë diçka tjetër vazhdon. Mund të njihemi me fatin e

një njeriu që ka luftuar. **Linda Seres**, për herë të parë flet në publik për

periudhën e vështirë të jetës së saj, pastaj për gjetjen e qetësisë. Vajza

në moshën 17 vjeçe humbi të ëmën, pastaj mardhëniet e saj me

të atin u prishën dhe kështu i mbeti rritja e katër motrave

dhe vëllezërve (në atë kohë nga 2-13 vjeç). Nuk kishim

çtë hanim, nuk kishim me se të ngroheshimi, nuk

kishim asgjë” - tregon ajo. „E kuptova se nuk

kisha kujt tja lija përgjegjësinë për ta, përveç

vetes time, dhe nuk e lashë që vëllezërit e

motrat e mija të mbeteshin në hall. Vendosa

të bëhesha kujdestarja e tyre dhe ia arrita”. Jeta e kësaj familje të vogël u stabilizua

kur Linda u njoh me **Máté Seres**, i cili

mori përsipër atë me gjithë vëllezërit dhe

motrat, kështu njohëm çiftin Seres, të cilët

që nga ajo kohë kanë qënë rrjetndërtues

të sukseshëm. „Më kthyen besimin tek

familja, ata u bënë model për mua” – thotë

Linda, që tani bashkë me të shoqin i është

përveshur biznesit. „Vendosëm, që kjo do të

jetë jeta jonë. U binda që ky biznes, të jep

atë zhvillim personaliteti për të cilin kisha

nevojë... Mundet të jetë shumë i thellë, por

gjithshka mund të zgjidhet. Do të doja që





këtë model ta përcillja edhe më tej në familjen time."

Motrat e Lindës kërcejnë në skenë: vëllai vogël që nga ajo kohë është bërë goxha djalë, dhe na dëshmon për një talent të pabesueshëm – historia e tyre e përbashkët prek gjithë publikun.

Një fat tjetër interesant është ai i senior menaxheres **Rita Kobza**.

Sikurse thotë ajo, ajo vjen nga qëndër banimi e vogël, me një situatë pa perspektivë dhe pa ndonjë të ardhme. Për disa muaj mundësinë Forever nuk po e kuptonte, madje as telefonin nuk e ngrinte... pastaj pas historive të trishtueshme pranoi që

fati ta shtynte drejt këtij biznesi. Pë të kaluarën e saj nuk ka qejf të flas shumë, por më shumë për ku synon sot, në vend që të priste për të. „Në jetën time ka harmoni, siguri dhe kështu dua të jetoj. Pa këtë shtylla ime kurrizore nuk do të ishte e drejtuar, do të mund të përtypja çamçakiz, ndërsa sot mund të jem shpresë në jetën e njerzve. E kam kuptuar se me ata që jam takuar këtu, nuk janë thjeshtë më të pasur, por janë edhe ndryshe nga të tjerët, që kam patur në punë tjetër. Në qoftë se do të rrija atje jam e sigurtë se njëzet të tjerë prisnin për vendin tim të punës. Në vënd të asaj këtu marr atë që konsiderohem si e veçantë. Ky vend pune të ofron jo vetëm para, por edhe një mënyrë tjetër të menduari, komunitet, respekt njerëzor. Mos prit çudira, merr në duart e tua vetë jetën tënde. Beso në atë që mund të ëndërrosh, së pari duhet të zgjohesh. Viti yt 2013, mund të të sjellë ndryshime cilësore, që çdo ëndërr të bëhet realitet!”

Pas kualifikimit të asistent supervisorëve të rinj, diamant menaxheri **Miklós Berkics** mban leksionin e vlerësimit të vitit që shkoi dhe fillimin e vitit të ri.

„Në atë kohë kur e filloi **József Szabó**, as që nuk do ta kishim menduar në sa fate njerzish do të ndikoni. Shumë nga ata që bënin një jetë tjetër, apo që ishin fëmij të vegjël, sot prezantohen në skenë. Për mua ditlindja ime në Forever është 16 janari 1997, kur u futa në këtë biznes, që nga ajo kohë kam më shumë energji, më shumë vull, gjithnjë e më tepër ëndëroj gjëra të mëdha,

*Jeni kuriozë çfarë i
motivon menaxherët e
rinj, atëhere shfletoni
faqen 26!*





sepse e kam kuptuar gjithnjë e më mirë, se ç'është kjo mundësi, ku para 16 vjetësh, hyra si një pikë uji." Sivjet përfunduan shumë gjëra të formës së vjetër, por asnjë vit nuk kemi marrë si shkëmbim aq gjëra të reja sa po na sjell viti 2013. Pas ca kohësh në Hawaii do të mund të festojmë 35 vjetorin e FLP, „nuk ka një shembull tjetër të një firme të marketingut në rrjet të ketë prezantuar produkte të tilla, le të quhet evolucion, zhvillim, e tash revolucion, një revolucion i vogël, apo forevolucion: tani vjen vala e tretë" thotë Miklós dhe na rrëfen për një libër të sapo dalë në qarkullim „për jetën e pasur". Për një vetëtrainim të vazhdueshëm, CD dhe librat trainuese kanë rëndësi themelore për punën në Forever, por duhen përzgjedhur mirë. Miklós na rekomandon serinë e re në Turbo Start: „Në qoftë se biznesi nuk të ecën, në këto CD mund të gjesh zgjidhjen!" Është mirë të rikujtosh dhe përjetosh përshtypjet e vitit 2012 me Miklós Berkics-in: Ishte një vit i mrekullueshëm! Diamant zafir të rinj, zafir, një numur i madh soaring e senior menaxherësh ...në tridhjet vjet Rally European më i madhi dhe më spektakulari në Budapest..." Dhe megjithëse nuk do të ketë më Rally European, në vend të tij do të kemi takimin e menaxherëve Eagle në Sardenjë, ndërsa në vend të Porecsit do të kemi në Opatija një shpërblim të vërtetë për ata që do arrijnë nivelin e kërkuar. Nuk do të ketë më World Rally dhe Super Rally, por në vend të tyre do të kemi Global Rally: „për të gjithë ata që arrijnë 1500 pikë!" Në muajin Nëntor, mundëm të kontabilizonim në llogari një rritje spektakolare të xhiros falë produktit Kids dhe kutisë ekskluzive Toucs". Për këtë të fundit për mundësitë e shkëlqyera të udhëtimeve me skonto dhe për tarifat telefonike na flet Zsolt Tamási, i cili me grupin e tij punon vazhdimisht për mundësi të reja. Dita e Suksestit të ardhshëm na pret më 19 Janar, ndërsa 16-17 Shkurt 2013 na pret Seminari i Diamantëve: „Një seminar i tillë deri më sot nuk është zhvilluar: tre diamant menaxhera, një dopio diamant, zëvendës presidenti i FLP për Europën, trainuesi numer një i botës Brian Tracy, të gjithë në Budapest! Pra të zhvillohemi, kushdo do ta gjejë kohën, sepse bëjmë revolucion mbasi kemi endërra të mëdha. Vepro, ashtu si unë, më ndiq mua dhe do të arrish atje ku kam mbërritur edhe unë! Në qoftë se vjen me ne dhe ke besim tek vetvetja, endërrat e tua për 2013 nuk mund të shuhen. Argëtohemi, punojmë, dhe marrim të gjitha dhuratat që na jep Foreveri në tabaka!"



Success Day

OPATIJA 23 NËNTOR 2012.



Organizimin e Ditës së Suksessit të Ditëlindjes të FLP Kroaci e filluam direkt mbas mbarimit të Holiday Rally-it, mbasi nga çdo pikëpamje ishte fjala për një ditë të veçantë. Kjo ishte një ditë kur o të titulloheshin shumë supervizorë,

Në sallën e kongreseve të Hotel Ambasador të Opatisë, të zbukuruar në mënyrë të veçantë, u mbledhën shumë distributorë nga Kroacia dhe nga vendet e rajonit. Festën e ditëlindjes, e nderoi me prezencën e tij edhe drejtori i përgjithshëm **Dr Sándor Milesz** dhe bashkëshortja e tij **Anna**, drejtori rajonal i Bosnjë-Hercegovinës **Dr Slavko Paleksić** dhe bashkëshortja e tij **Mira**, drejtori rajonal i Serbisë, **Branislav Rajić** dhe bashkëshortja e tij **Ana**, drejtori rajonal i Sllovenisë **Andrej Kepe**, diamant menaxherët **Veronika** dhe **Stevan Lomjanski** si dhe zafir menaxherja **Ágnes Krizsó**.

Pas ngjitjes në skenë të distributorëve më të sukseshëm të rajonit, këtë ditë festive e hapi me këngë **Damir Kedžo**, fitues i shfaqjes të talenteve Super Nova show. Bashkë me Damir-in kënduan hitet Giboni dhe Oliver. Rolin e drejtuesit të programit e morën menaxherja dhe radiologia **Jasminka Petrović** dhe senior menaxheri dhe pioneri i FLP të Kroacisë **Albert Keresztényi**. Ata prezantuan dhe falnderuan bashkpunëtorët e Kroacisë si dhe miqtë e respektuar të ardhur nga Sllovenia, Serbia, Bosnje-Hercegovina dhe Hungaria.

Lektori i parë ishte drejtori i FLP Kroaci, **Dr László Molnár**, që na prezantoi disa nga gjërat më të reja. Mbrirën pakot e dhuratave për Krishtlindje: kuti të zbukuruar të përgatitura me produktet e FLP, me të cilat mund



tu japim një kënaqsi të vërtetë miqve dhe pjestarëve të familjes. Si plotësim jepet një qiri FLP si dhe një katalog i krishtlindjeve! Përveç kësaj të gjithë bashkpunëtorët, që morën distiktivin e asistent supervizorit, mundën të marrin si dhuratë edhe nga një CD me leksione MLM. Një risi tjetër ishte ajo që anëtarët e FLP Kroaci së shpejti mund të telefonojnë falas ndërmjet njeri tjetrit. Gati para përfundimit është blerja me internet webshop si dhe zhvillimi i faqes të reklamës në internet për publikun. Po kështu në Zagreb dhe Rjeka do të hapet biblioteke me libra të marketingut MLM, ku bashkpunëtorët mund ti mund ti marrin ato hua. Dhe shkuma përmbi tortë në fund: xhiroja në Kroaci u rrit me 29%, që do të thotë rritja më e madhe e xhiros në 5 vitet e fundit.

Pastaj **Dr László Molnár** ftoi në skenë drejtorin e përgjithshëm **Dr Sándor Miliesz** i cili mbajti një leksion të shkëlqyer për rritjen e firmës sonë. FLP përbëhet nga njësi të veçanta. Çdo njësi ka ka skuadrat e veta me njerëz të tillë, që kujdesen që brënda rajonit të tyre gjithshka të vazhdojë në rregull. E gjithë kjo në fund formon një njësi të fuqishme. Në FLP ka një zhvillim të vazhdueshëm që është në të mirë të distributorëve tanë. Dr Sándor Miliesz përshëndeti ditëlindjen e FLP Kroaci dhe pastaj i uroi një zhvillim të mëtejshëm fantastik, të paktën të tillë si ky i këtij viti.

Pastaj në skenë bashkë me drejtorin e përgjithshëm u ngjiten drejtorët e zyrave rajonale **Dr. Slavko Paleksić, Branislav Rajić** dhe **Andrej Kepe**, si dhe zafir menaxherja **Ágnes Krizsó**. Ata përshëndetën ditëlindjen e FLP Kroaci në emrin personal dhe në emër të bashkpunëtorëve të tyre, duke uruar edhe për shumë ditëlindje të tilla. Ágnes Krizsó falnderoi drejtorin rajonal, **Dr László Molnár** si dhe të gjithë bashkpunëtorët e zyrave të Zagrebit dhe të Rjekës për ndihmën e gjithanshme që i kanë dhënë Ágnes-it distributorët e Kroacisë. Ágnes kan ë Kroaci linjën më të fuqishme dhe më të sukseshme, pikërisht për këtë ajo falnderoi me fjalë të ngrohta bashkpunimin dhe zhvillimin fantastik.

Menaxheri **Dina Zastavniković**, kujdeset edhe për prezencën e publikut në faqen web të FLP. Nga leksioni i tij mundëm të njiheshim me mënyrën e lidhjes, si dhe për mundësitë e zgjerimit të lidhjeve nëpërmjet internetit. Portali i publikut i FLP të Kroacisë është në dispozicion të anëtarëve të FLP. Aktiviteti i këtushëm rrit komunikimin, dhe nëpërmjet tij edhe efektivitetin e punës, mbasi të gjithë jemi anëtarë të komunitetit të FLP Kroaci! – u shpreh në mbyllje të leksionit Dina. Ndërkohë që ne dëgjnim dhe mësonim nga ky leksion, në Facebook dhe Twitter mundëm të shikonim fotot e para të përgatitura në këtë aktivitet. Kjo është një nga avantazhet e internetit.

Në leksionin e tij **Tilen Horvat** na prezantoi webshop-in. Kjo është një nga platformat e reja që mund të shfrytëzohet ekskluzivisht nga anëtarët e regjistruar. Pas paraqitjes mund të blehet, por mund të shikohen edhe të dhënat e xhiros.





Tilen na i prezantoi hapa pas hapi mënyrën e paraqitjes, pastaj blerjen e produkteve me webshop si dhe procesin e pagesës të faturës.

Dr. Alena Buretić Tomljanović – menaxhere e Rjekës, erdhi me temën mjekësore: Të alkolizohemi me Aloe! Dëgjuam një leksion shumë interesant dhe mësimdhënës. Sa i rëndësishëm është aciditeti për organizmin tonë këtë pak e dimë. Dhimbjet dhe sëmundjet kronike shkaktojnë mungesë oksigjeni, si dhe një aciditet të tepërt në nivel qelizash. Si të hamë dhe çfarë ushqimesh duhet të shmangim, si dhe çfarë game të gjërë të produkteve të FLP kemi në dispozicion, që na ndihmojnë për mënyrën e duhur të jetesës, këto mundëm ti mësojmë nga leksioni i saj jashtzakonshëm.

Për etikën dhe moralin në punë na foli në leksionin e tij miku nga Sllovenia, zafir menaxheri **Tomislav Brumec**. Çdo ditë ndjejmë pasigurinë dhe efektet e dëmshme të krizës financiare, ndërkohë që në fokusin e procesit të çdo biznesi qëndron faktori njeri: njeriu që merr vendime. Duhet të dalim nga rutina e vjetër: vetëm kështu mund të rezistojë dhe zhvillohet një firmë, por edhe e gjithë shoqëria. Etika kërkon qëndrimin e duhur ndaj biznesit dhe të bëhesh forcë lëvizëse e zhvillimit të qëndrueshëm të tij, ndërsa normat etike na duhen për të vendosur dhe rregulluar marrëdhëniet me mjedisin: vetëm kështu mund të rritet edhe firma – thotë Tomislav.

Pas kësaj vazhdoi kualifikimi i supervizorëve dhe asistent menaxherëve të rinj. Skena ishte e vogël për të kualifikuarit e shumtë. Ishim tepër të lumtur nga gjithë kjo masë, nga gjithë këto fytyra të qeshura, dhe nga gjithë ata pjesmarrës në festë që do të donin të ishin pranë të kualifikuarve. E gjithë salla duartrokiste duke qëndruar në këmbë.

Pas pushimit **Jasna Palić Picukarić dhe Mila Elegović** me prezantimin e tyre të marketingut MLM na bënë të qeshim me lotë, duke u përprekur në gjuhën hungareze si me një njeri që është „i detyruar” të mësojë një gjuhë të re.

Sandra Jagodin, menaxherja e sapokualifikuar në Porecs, në këtë Ditë Suksesi mbajti leksionin e saj të parë. Na tregoi historinë e vet. Na foli për gjithshka që parapriu lidhjen me FLP dhe si u mor vendimi duke na i ilustruar me foto të përgatitura në familje. Nuk la pa falnderuar as Dr Albert Keresztényi, mbasi ai kontribuoi veçanrisht për marrjen e vendimit dhe arritjen e suksesit të saj.

Ishte një nderim i veçantë që distiktivin e merituar ta merrje nga dora e drejtorit të përgjithshëm. **Dr Sándor Milesz** u dorëzoi personalisht distiktivin, menaxherëve të sapo kualifikuar, sesior menaxherëve, soaring dhe eagle menaxherëve si dhe atyre të kualifikuar për stimulin e autoveturës. Duke qëndruar në këmbë festonte e gjithë salla, duke u gëzuar të gjithë bashkë për sukseset e bashkpunëtorëve tanë.





Rinalda Iskra – senior menaxhere, na tregoi se si mund të plotësohen pikët për stimulin e makinës. Pas marrjes të vendimit, e gjitha duhet ndjekur me hapat e shkallëve të para dhe duhet kujdesur për pikët. Pse të mos e shfrytëzojmë atë që mund ta marrim si dhuratë duke ndjekur çdo muaj për tre vjet? Kjo është një e ardhur plotësuese, veç bonusit. Të ndihmojmë të tjerët të bëhen të sukseshëm, sepse ashtu bëheni edhe vetë! Bëni atë që nuk e bëjnë të tjerët, që pastaj të jeni ju ata që të tjerët nuk janë – e përfundoi Rinalda bisedën e saj.

Pastaj vazhduam me pak muzikë nga miku ynë Damir Kedžo : të mrekulluar nga zëri i tij i bukur.

Të bashkuar jemi më të fuqishëm – na dhanë si mesazh në leksionin e tyre, **Sonja dhe Zlatko Jurović** - soaring menaxherë, të cilët plotësojnë shumë njeri tjetrin. Zlatko si forca shtytëse, si drejtues, ndërsa Sonja, „i lëshon“ atij që të besojë se ai është shef. Zlatko gjithmonë është gazmor dhe kur rremat e gazmorit e largojnë nga ujrat e seriozitetit, është Sonja ajo që e kthen në drejtimin e duhur. Njëpërmjet fotove na rrëfejnë jetën e tyre, dhe me komentet frymëzuese që i karakterizojnë ata, na tregojnë deri në fund rrugën e tyre , duke na treguar për fillimet, pastaj rrëzimet, pastaj për jetën e tyre në Forever, për atë jetë që gjithmonë e kishin ëndërruar, por që tash është bërë realitet. Falnderuan shumë vetë, si sponsorët dhe mjeshtërit që i kishin mësuar, por edhe linjën poshtë tyre pa të cilët nuk do të arrinin të bënin jetën e tyre të ëndërruar.

Në fund të Ditës së Suksessit të Ditëlindjes, ju dorëzua distiktivi i shqiponjës së artë atyre bashkpunëtorëve që në 2 muajt e fundit u kualifikuan si asistent supervizorë, duke u ngjitur në shkallën e parë të rrugës drejt suksesit. Shpresojmë që në këtë festë të ditëlindjes të FLP Kroaci të kenë fituar guxim, dhe të kenë marrë krahë për të fluturuar gjatë dhe me sukses.

Diamant menaxherja **Veronika Lomjanski** është një mik gjithmonë i përzemërt. prej vitesh pranon pa egoizëm ftesat tona që të përcjellë përvojën dhe dijet e saj të pasura për FLP, për të na treguar se si duhet punuar, duke na dhënë „recetat e suksesit“. Duke dëgjuar Veronika-n bindemi se sekreti fshihet te vetja jonë: tek qëndrimi, tek sinqeriteti, tek gatishmëria për të ndihmuar, pavarësisht se kë ndihmon dhe kujt linje i përket. Leksionet e Veronika-s është e pamundur ti përshkruash, thjeshtë ato duhen dëgjuar që të kuptosh mesazhin. Faleminderit Veronika dhe Stevo, që me prezencën tuaj i dhatë më shumë dritë festës sonë.

Si përfundim edhe një herë përsëritim ditëlindjen e FLP Kroaci me urimin që së bashku të festojmë edhe shumë ditëlindje të tjera!

Dita e ardhshme e Suksessit do të jetë në Zagreb, në hotel Panorama, më 23.3.2013. Ju presim me dashuri!

Dr. László Molnár
Drejtor rajonal





A I MERR ERA FJALËT?

Tashmë një vit më parë nga pena ime u botua shkrimi „Fjalët i merr era...”

Tanimë po pyes: A i merr era fjalët?

Ka raste kur një fjalë mjafton, por ka edhe raste kur edhe dokumenti me shkrim është pak. Për çfarë? Për traktate, për marrëveshje, për betime, për premtime.... Ka ushtri që bëjnë traktate, por megjithatë e shkel ai që do që ta shkelë. Ka shtete që lidhin pakte për paqe, por dihet që në prapavijë përgatiten për beteja të përgjishme. Ka nga ata që lidhin ujdë pazarllëqesh, që i gdhendin në gur, por pastaj guri bëhet pluhur...

Por ka edhe të tilla, kur mjafton një shtërngim duarsh, pra ka edhe një „**gentlemen's agreement**” ose marrëveshje zotnësh. Le të shikojmë për këtë formulimin e fjalorit:

„Një marrëveshje ose rënie dakort e heshtur, jo zyrtare ,që bazohet tek fjala e dhënë”.

Pra e tillë kur shikojmë njeri tjetrin në sy, dhe brënda ka diçka: pra mund të më besosh! Kështu i besojnë jetën njeri tjetrit, ushtarakët, bashkëluftëtarët. Pilotat kështu kanë besim tek navigatorët e tokës, burrat dhe gratë tek dashuria midis tyre.

Para se dikush të mund të ofendohet, prisni dhe vrisni pak mendjen: as unë nuk kam mbajtur çdo premtim, as unë nuk bëj përjashtim, nuk jam shenjt, as më i mirë nga Ti apo Ju! Por shkrimi ka lindur pikërisht për një qëllim:

Për të falnderuar ata që mbajnë premtimin! Për të falnderuar sponsorin tonë Tecá Herman, që na njohu me këtë mundësi. Të falnderojmë linjën tonë të sipërme që patën besim tek ne. JU FALEMINDERIT!

Faleminderit Szilárd dhe Márta Fekete, që u bëtë menaxherë. faleminderit djalit tonë Bencé, që me gjithë moshën e re , e çoi në mënyrë të përsosur atë që planifikoi. E bëri deri aty dhe deri aq sa...çdo të thotë kjo? Caktovë një objektiv, atëherë bëje deri aty , aq sa ta arrish! Ju fute, që ju fute! Mos ndalo pse të tjerët do të thonë tjetër gjë, mos u dorëzo, vetëm pse ajo është më e lehtë. Bëje deri sa ta arrish. Në qoftë se pengohesh, konsultohu, rishkruaj afatet – por jo objektivin! (pra në qoftë se edhe sipas sponsorit tënd objektivi është i mirë, dhe nuk bie ndesh me moralin e mirë.) Edhe ne premtuam dhe e mbajtëm atë. Vjet në Porecs dhamëm fjalën se deri në dhjetor 2012 do të arrijmë Diamant-zafrin. Ia dhamë fjalën Robi varga-s, ia thamë në sy Dr Sándor Milesz, ju përgjigjëm një pyetjeje të Miki Berkics-it, dhe ua deklaruar nga podiumi mijra vetëve.

Robin Sharma: Oshënari, që shiti Ferrarin e tij, në librin e tij me këtë titull ka edhe përgjigjen pse deklaroi Robi Varga se çfarë duam të arrijmë. I mënçuri Szivana ka përpunuar një teknikë me pesë shkallë për arritjen e objektivit të caktuar:

1, Formo një pamje të pastër vizuale të të menduarit për rezultatet e pritshme (për caktimin e objektivit).

2, Mbushe me pak detyrim. (për shembull deklaroje në podium, formuloje me shkrim në një gazetë, vendose në Facebook, bjeru borieve ta dëgjojë bota...)

3, Cakto afatet.

4, Hidhe në letër.

5, Bëje zakon punën drejtuese, dhe atë që në mënyrë të vazhdueshme patjetër të punosh të paktën 21 ditë! Ndërkohë braktisi ato zakone që të pengojnë (Me një fjalë puno, bëj prezantime çdo ditë, harroje televizorin, lojrat në kompjuter apo çdo gjë tjetër që të ha kohën kot!)

Të kesh një panoramë të qartë vizuale... Le tu tregoj shembullin e këtij djali. Më kujtohet kur Bence u ngrit me endërrën sikur u bë

menaxher. Edhe ishim në endërr për diamant-zafir. Pra pamja ishte endërr. Megjithatë u zgjua duke psherëtirë.

E pyeta:

- Pse?

- *Sepse dikush më parakalojë – mu përgjigj, dhe unë nuk u bëra këmba e shtatëmbëdhjetë! (dmth menaxheri i 17-të i diamant-zafir – shënim i përkthyesit)*

E kuptoni? Endërra, ky ishte imazhi: Jam menaxher, prindërit BASHKË ME MUA do të jenë diamant-zafir. Pa imazhin sikur bashkë po ngjiteshim në podium e kampionëve. Pa imazhin sikur qanim sëbashku nga gëzimi. Pra imazhi ishte gati, ai i ngjalli ndjenjat e forta.

E deklaroi në skenë, e përshkroi në revistë. Eshtë e vërtetë që këtë e caktoi për më 31 janar. (Por sikurse thotë miku im Máte Kiss Imi: Me gabime të vogla edhe pianoja flet...)

U ulëm me Bencen dhe planifikuam me detaje. Në Majd he Qershor të hidhte bazat, duke zgjeruar me njëmijë vetë. Rita bënte prezantimet e paketës kozmetike Sonya. Duhej të gjendeshin ata 3 vetë që donin të bëheshin supervizorë ose që donin të vinin në Porecs (dy thuajse ishin gjetur por i treti as nam as nishan...) Për dy muaj Korrik-Gusht, u arrit gjithshka! Tamam atëhere dhe aq sa duhej... U bënë 3 vetë kandidat për nivelin e supervizorit: Laci Pellei dhe Valika, Balázs Leskó Balázs dhe djaloshi, Roland Bernáth Roland (sa interesant, Roli tejkaloi shumë edhe 25 pikëshin...).

OBJEKTIVIN e hodhi në letër, madje disa herë. Në ditarin e afateve, në fletoren e objektivave, në fletoren e listave... Pastaj punoi, u konsultua, planifikori. Ju bë zakon puna. Çdo ditë bënte 5-6 prezantime. Disa herë edhe vetëm gjysëm ore. Për këtë duhet të lesh mënjane gjerat e tjera. Më pak argëtime, shetjitje. Pa kinema, madje edhe pa televizor në mbrëmje. U çmësua me to... Për diçka tjetër! Si i thonë asaj fjalës?

„Në qoftë se bën ato gjëra që të tjerët nuk i bëjnë dot, më vonë mund ti bësh edhe ato që të tjerët i bëjnë!”

Zyra jonë u kthye në një koshere bletësh. Unë çdo të hënë bëja trainime plus për Porecsin, ndërsa çdo të martë grupoja fillestarët. Ndërkohë të tjerët mblidhnin qindra të tjerë 1 me 1 apo 2 me 1, ndërsa Rita merrej me kozmetikën. Kishte raste kur bisedonim në këmbë në koridor, bënin prezantime edhe djemtë sepse në të 3 dhomat vazhdonte puna njëkohsisht. U shfaq hapur një „kastë” e re, ajo e të rinjve të ethshëm. Ne vinim rrotull mes tyre të veshur me kostum. Ata ishin fëmijët tanë, por nëpërmjet tyre u rinuam edhe ne.

Një çast e shikuam Bence-n në sy dhe e pyetëm:

- *Mos është më mirë të mos shkojmë takimin e Las Vegasit?*

- *Jo na u përgjigj në mënyrë të vendosur, do të bëjmë edhe pa ju!*

Nga Amerika telefonoja në shtëpi i tensionuar?

- *Hë, kemi ndonjë gjë të re, si po ecni?*

- *Rri i qetë, do ta realizojmë – vinte vazhdimisht përgjigja me tendosje nervore.*

- *Po hë pa më thuaj!*

- *Babi, u mësua edhe pa ju. Tani mezi pres, që tju njoh me grupin e ri! Të premten bëra porosinë, por të shtunën më erdhë 5 të regjistruar të rinj, gati për të blerë. Me një fjalë kështu po ecën.*

Pastaj filloi krenaria: Ja im bir! Tamam si unë, vetëm më i bukur, si i ri! Ata që na shikonin nga jashtë si Dr Sándor Miliesz, Péter Lenkey,

Józsi Szabó, Miki Berkics, Ari Vágási, sponsorit tanë Teca Herman, por edhe pagëzuesit tanë si Attila Gidófalvi, Robi Varga, Hajnika Senk, çiftet Sanyi Tóth, Seres, Bruckner e Juró, bashkëudhëtarët tanë për në Amerikë, të gjithë bënë tifozllëk për ne, pyesnin si po ecën djali?

Eh, të dashur miq, kjo është jeta, të ikësh si zafir dhe të kthehesh në atdhe si diamant-zafir! Sikurse u shpreh Ari: familja Halmi ndodhet në të njëjtin paralel gjeografik! Bence në Hungari, ndërsa ne në Arizona. Por më më e bukura ishte:

Kur u nisëm për në Amerikë, në Hungari lamë djemtë Bajnok-un dhe Bencé-n, ndërsa kur u kthyem krahas buzëqeshjes të Bajnok-ut akoma i vogël, na priti edhe një burrë. Kjo është fjala e nderit e dhënë nga një burrë!

Pra a fluturojnë fjalët? Le të kthehem pak mbrapa në kohë:

Dy vjet më parë isha në Siofok, si i ftuar për një leksion, në një takim 2 ditor të organizuar nga Dr Sándor Miliesz. Pas leksionit Sándor na ftoi të hanim darkë me Dr László Molnár – mua, Ritá-n dhe djalin e vogël Bajnok. Gjatë Gjatë bisedës Sándor na tregoi se me rastin e ditëlindjes kishte një biletë për ndeshjen Barcelona – Real Madrid El Clásico. Kaq u desh që Bajnok-ut ti ngrihej mendja!

- *Xhaxhi Sanyi, mund të sigurosh biletë për në El Clásico? – e pyeti.*

- *Po – qe përgjigja e tij (sipas meje pak e nxituar).*

- *Vërtet?*

- *Sigurisht, ju përgjigj Sándori aty për aty.*

Sándor mund edhe të mos e dinte, çfarë po bënte. Por tek fëmija ngjalli një shpresë, një besim për arritjen e një dëshire të madhe. Po si të mos e dinte kur edhe ai ka gjashtë fëmijë, dhe e ka idenë se si punon mendja e fëmijve. Dikush tjetër edhe mund ta kish harruar, por Sándori jo!

Fjalët i merr era, por shpresa që ngjalli nëpërmjet besimit mbetet.

Vërtet fjalët i merr era, por Por ka edhe dhënie fjale nga ata, që janë si një traktat. Kjo quhet „*gentlemen’s agreement*” (*marrëveshje xhentëlmenësh*). Është kjo ajo që i mban të lidhura rrjetet, miqësitë.

Dr Sándor Miliesz si një Non plus ultra siguroi 3 bileta El Clásico.

Ky është nderi i babait të PASUR! Këtu fjalët nuk i merr era...

Si të duket një biletë për një ndeshje „live” duke qëndruar në rreshtin e katërt, ku dëgjohej taka e këpucës dhe frymëmarrja e Messit? Si të duket të jesh te katalanët, me djemtë në „Szentély”. Në qoftë se të duket interesante, ec! Realizojë, dhe ec se ia vlen! Në qoftë se nuk të duket interesante, atëhere nuk mund të ecësh në gjurmët? Një gjë është e sigurtë: në Hungari u kthyem ndryshe! U kthyem si njerëz që për fjalën

e mbajtur, të dehur nga fruti i premtimit të mbajtur kup-tuam fjalët e Heminguejt:

„Shembulli personal nuk është një nga mënyrat, por e vetmja mënyrë e edukimit!”
Faleminderit Bence, faleminderit miq, Faleminderit Sándor!

Sikurse këndon Freddie Mercury: Show must go on! (Shfaqja duhet të vazhdojë). Sándor dije: „Elefanti nuk harron!”

Go Diamond:
István dhe Rita Halmi





HOLIDAY RALLY

Opatija

PERIUDHA E KUALIFIKIMI: 1 JANAR 2013 DERI 30 PRILL 2013.

KUSH MUND TË KUALIFIKOHET?

Çdo distributor i ri apo i vjetër, që nga niveli aktual ngjitet të paktën një shkallë më lartë në planin e marketingut (nga shkalla e distributorit mund të kualifikohesh vetëm në qoftë se arrin shkallën e supervizorit). Mund të marrin pjesë edhe të risponsorizuarit !

CILAT JANË KUSHTET E NEVOJSHME TË KUALIFIKIMIT PËR KËTË PROGRAM STIMULIMI?

Ngjit shkallën! Gjatë periudhës të jesh Aktiv (pra 4 pikë, nga të cilat 1 pikë të jetë në emrin e vetë) që nga muaji i parë i plotë, domethënë në qoftë se je regjistruar më 15 shkurt 2013, atëherë fillon nga 1 marsi. Në krahasim me nivelin tënd ekzistues duhet që në planin e marketingut të ngjitesh një shkallë (ata që janë në nivel distributori duhet të arrijnë nivelin supervizor). Ky është Niveli i I-rë i Holiday Rally-it. Pas kualifikimit, deri në fund të periudhës të kualifikimit përsëri duhet të plotësosh në dy muaj të njëpasnjëshëm kushtet e kualifikimit, domethënë për shembull nga niveli i distributorit ose asistent supervizorit arrite nivelin supervizor në Mars, atëherë krahas ruajtjes të qënies aktive, xhiroja jote e shkurtit dhe marsit mblidhen bashkë, po kështu marsi me prillin bashkë duhet të jenë përsëri 25 pikë. Në qoftë se nisesh nga shkalla e supervizorit dhe arrite shkallën asistent menaxher në Qershor, atëherë krahas ruajtjes të qënies aktive, xhiroja jote e Qershorit dhe Korrikut së bashku si dhe e Korrikut me Gushtin së bashku duhet të jetë përsëri 75 pikë dhe kështu me radhë: në kualifikimin për nivelin e II-të të programit Holiday Rally. Në qoftë se je regjistruar në muajin e fundit të periudhës të kualifikimit dhe ke plotësuar kushtet e kualifikimit për Holiday Rally, atëherë në Holiday Rally nuk mund të marrësh pjesë në akomodimin e VIP-ave, por sigurisht je kualifikuar për nivelin e I-rë. Ai që gjatë periudhës të kualifikimit ngjit dy a më shumë shkallë të planit të marketingut, ai në Holiday Rally merr pjesë në akomodimin e VIP-ave, pra ka arritur nivelin e II-të.

AKOMODIMI:

në hotel me 4 yje, duke përfshirë gjithshka.

Bashkpunëtorët e kualifikuar për Nivelin e II-të do të shkojnë me autobus VIP, dhe gjatë aktivitetit do tu shërbehet në bufe VIPash dhe do të ketë pika shitje për VIP-a duke mos pritur në radhë. Bashkpunëtorët e Nivelit të I-rë, udhëtimin e tyre duhet ta mbulojnë me shpenzimet e tyre, por sigurisht mund të marrin falas shërbime të firmës.

KUR DHE KU DO TË JETË HOLIDAY RALLY?

Vendi aktivitetit në Opatija të Kroacisë, 4-5 Tetor 2013

PROGRAMI
TRAINIMEVE DHE
DITËVE TË SUKSESIT TË FLP

FOREVOLUTION

2013

JANAR	19. Success Day Budapest, SYMA Csarnok		27. Success Day Beograd	
SHKURT		16-17. Berkics Miklós Trainim nga diamantët Budapest, SYMA Csarnok		
MARS	30. Success Day Budapest, SYMA Csarnok		23. Success Day Zagreb 23. Success Day Ljubljana 24. Success Day Beograd	
PRILL		21-29. Global Rally Hawaii	6. Success Day Sarajevó	13. Dita e Turbo Start Në Jakabszállás
MAJ	11. Success Day Budapest, SYMA Csarnok 12. Dita e IV. e Shëndetit Budapest, SYMA Csarnok	23-26. Eagle Manager Retreat në Sardenjë	18. Success Day Ljubljana 19 Success Day Opatija 19. Success Day Beograd	
QERSHOR		8-9. Berkics Miklós Trainim nga diamantët Budapest, SYMA Csarnok	23. Success Day Beograd	
KORRIK	20. Success Day Budapest, SYMA Csarnok			
GUSHT				10. Dita e Turbo Start Në Jakabszállás
SHTATOR	14. Success Day Budapest, SYMA Csarnok	15-22. GO DIAMOND Bullgari	28. Success Day Ljubljana 29. Success Day Beograd	
TETOR		5-6. Holiday Rally Opatija 12-13. Berkics Miklós Trainim nga diamantët Budapest, SYMA Csarnok	20. Success Day Opatija	
NËNTOR	16. Success Day Budapest, SYMA Csarnok		23. Success Day Ljubljana 24. Success Day Beograd	30. Dita e Turbo Start Në Jakabszállás
DHJETOR			7. Success Day Bijeljina	

BEOGRAD 2.12.2012

**PËRJASHTA BËN
FTOHTË, POR
ZEMRAT NA I
NGROH FOREVERI.
MIRË SE ERDHE
DITA E SUKSESIT E
DIMRIT!**

Drejtues të programit ishin zafir menaxherët **Marija dhe Boško Buruš**. Në Forever ata janë një legjendë e gjallë, janë drejtues të një grupi bashkpunëtorësh stabël dhe të zellshëm. Nga duartrokitjet e zjarra të përshëndetjes së tyre duket qartë që janë shumë të njohur në FLP.

Branislav Rajić, drejtori rajonal i FLP Serbi, siç është tashmë tradicionale për fund viti, bën përmbledhjen e aktivitetit dhe të rezultateve të FLP. „Jemi krenarë për çka kemi arritur, dhe krahasuar me rrethanat, rezultatet tona janë maksimale. Kudo ku kemi shkuar jashtë kufijve tanë, vendin tonë e kemi përfaqësuar siç e meriton. Falnderojmë për këtë gjithë distributorët tanë, dhe shpresojmë se edhe në vitin që kemi përpara do të mund të na gëzojnë me suksese të reja!”

S U C C E S S



Forever Living Products e Serbisë përfaqson ide humane, dhe gjithmonë jep ndihmën e saj kur ka mundësi për të. Ka disa muaj që jemi anëtarë të rrethit të miqve të UNICEF-it, dhe lidhur me këtë përfaqësuesja e zyrës të UNICEF në Serbi **Vesna Đukić-Savić** na ka akorduar këtë pllaketë të veçantë si mirënjohje të ndihmës së dhënë nga FLP jonë. Jemi krenarë për këtë mbasi si besnik të ideve të Rex Maughan, themeluesit dhe presidentit të firmës sonë përcjellim ëndërrën për një jetë më të mirë.



Dr. Sándor Milesz - zafir menaxher, si drejtor i përgjithshëm i Hungarisë dhe i rajonit, u paraqit me një program dhe me stimuj të rinj. Teknikat e biznesit janë të njohura mirë për ne, ndërsa motivimi është karburant që të çon drejt suksesit. Besimi në vetvete dhe tek firma, si dhe vizioni për një jetë më të mirë, mund të sjellë kthesa në jetën e gjithkujt, prandaj edhe FLP është këtu për ti bërë ëndërrat realitet.

Mënyrat e jetës si dhe dietat e sotme dëmtojnë në një masë të madhe sistemin e kockave dhe të kërceve të çdonjerit nga ne. Falnderojmë **Dr Predrag Lazarević** - soaring menaxher për leksionin e shkëlqyer lidhur me këtë temë. Dihet se çfarë përpjekjesh të mëdha bën firma jonë në këtë fushë.

DAY

Një nga mjekët e parë, i lidhur fort me FLP, është **Dr Marija Ratković** - zafir menaxhere, e cila i përdor këto produkte qysh nga hyrja e tyre në tregun serb. Falnderojmë për leksionin e saj, që edhe nëpërmjet këndvështrimit të përdoruesve, na dha përvojën e saj për produktet tona. Mbas kësaj në skenë u ngjitën supervisorët dhe asistent menaxherët e sapo kualifikuar, duke ju uruar atyre shumë suksese në punën e mëtejshme. Shpresojmë që në muajt e ardhshëm ata do të përballojnë sfidat e duhura për kualifikime të reja, dhe shpejt do të pasurohen me distiktiva të tjerë.





Ansambli **GLAS NE ŽICE**, zbulimi i madh i këtij viti, na treguan se si zeri i njeriut mund të funksionojë si një instrument muzikor. Miqve të FLP edhe më tej ju urojmë një të ardhme të tillë të sukseshme.



Amerika nuk është shumë larg për bashkpunëtorët tanë. Këtë më mirë na i treguan me leksionet e tyre tre lektorët: **Mišo Janović** - soaring menaxher, **Boško Buruš** - zafir menaxher. dhe **Stevan Lomjasnki** - diamant menaxher. Ata sapo janë kthyer nga Amerika. Çdo udhëtim ka një histori të veçantë, ndërsa neve na u dha rasti që nëpërmjet fotove dhe bisedave të tyre të përjetojmë një pjesë të asaj që në Forever quhet programe stimulues. Këto vende janë të arritshme për cilindo, lidhuni me këtë shoqëri gazmore në udhëtimet e tyre rreth botës, të cilat do të lënë gjurmë edhe në jetën tuaj!

Thesari më i madh është ai, kur dijet që ia përcjell dikujt, ai mund ti shfrytëzojë. Shumë ngrihen shpejt por harrojnë esencën e punës së tyre. drejtuesit e jetës të botës së biznesit, sukseset i kanë arritur me një punë të zellshme dhe të përkushtuar, duke mësuar nga gabimet e të tjerëve, por njëkohsisht duke korrigjuar gabimet e veta. Kur formulojmë objektivat tona, atëhere na zgjohet vetëdija se çmimi që duhet paguar për to, është shumë më i vogël sesa vlera që do të marrim në shkëmbim të tij. Mirë se erdhët në Forever! – na dha si mesazh - menaxherja **Jovanka Štrboje**.



U titulluan si anëtar të Klubit të Conquistadorëve distributorët më të sukseshëm të vitit të kaluar. Secili prej tyre kishte një rritje prej 15 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërsa ata bashkpunëtorë që me skuadrat e tyre, muajin që shkoi kishin plotësuar mbi 60 pikë morën vlerësimin e tyre brënda kuadrit të klubit 60cc+. Urime!



Askujt nuk i lejohet të të thotë: ti nuk je i aftë të bësh diçka, dhe nuk mund ta bësh, aq më tepër për punën tënde! Sepse FLP pikërisht këtë siguron. Çelësi i suksesit është vizioni, ëndërra, qëndresa, vullneti për ta bërë, zhvillimi i vetvetes, guximi, sakrifikimi i kohës dhe qëndrimi pozitiv. Bazuar në këto e ka ndërtuar punën e saj **Dragana Janović** - soaring menaxhere.

Gjërat negative duhet ti ndryshojmë shpejt në pozitive – na dha mesazhin e saj diamant menaxherja **Veronika Lomjanski**. – Drejtohuni për ndihmë sponsorve tuaj! Egoja ime nuk shkoi në dëm të dijes, kam patur si plan të qartë që të lidhem direkt me sa më shumë bashkpunëtorë. Rezultati vjen vetvetiu dhe në Serbi krijova një skuadër diamantësh, nga më të fuqishmet në Europë. Për mua as që bëhet fjalë të tërhiqem nga diçka. Jam e miqësuar me njerëz të tillë, të cilët kanë ëndërra, kanë qëndrime pozitive për jetën, dëshirojnë progresin – u shpreh Veronika.

Asistent supervisorët ngjiten shkallën më të rëndësishme të planit të marketingut. Distikivi i shqiponjës është shpërblim i punës së tyre, ju urojmë atyre shumë suksese edhe në të ardhmen!

Dita e Suksesit e ardhshme do të jetë në Beograd në Shtëpinë e Sindikatave më 27 Janar 2013.

Të gjithë bashkpunëtorëve të FLP, ju urojmë krishtlindje të gëzuara dhe një vit të ri të lumtur!

Branislav Rajić,
Drejtore rajonal i FLP Serbi



MOTIVIMI: FORCA LËVIZËSE E BIZNESIT

Shumë vetë ndoshta mendojnë, që kjo punë nuk është për ata, nuk janë të aftë për të... Çfarë ju thanë juve atëhere, kur ju ftuan për një takim? Është biznes i mrekullueshëm, mund të fitosh shumë me të. Por që nuk ka sipër kufi... këtë a ta kanë thënë?



Ndërsa po ta shihni Foreverin si zgjidhje, mund të realizoni të gjitha ato që keni dëshiruar gjatë jetës tuaj. Nuk ka gjë më të lehtë dhe më të bukur se kjo: të arrijmë objektivat tona duke ndihmuar të tjerët.

Këtë ndjenjë ju a uroj të gjithë njerëzve: të shohësh, që atij personi, që futët në biznes, t'i realizohen dëshirat. Që ai dhe familja e tij jetojnë më mirë. Pikërisht këtë ndjenjë ju a uroj juve! Kur shikoj njerëz të lumtur dhe të kënaqur, që më në fund mund t'ju blejë fëmijëve (kur merr bonusin) çokollata apo atë, që nuk ka mundur t'ju a blejë vitet e fundit.

Ndonëse jemi njerëz të rritur, na ka ndodhur shpeshherë, që fëmijëve si dhe atyre që duam më shumë, të mos u themi të vërtetën. A ka ndodhur edhe me ju, që të thoni: "Babi do ta blejë pastaj, nëse do të marri rrogën." A ju a themi fëmijëve tanë? Dhe kush e di sa herë me muaj, me vite. Përse? Sepse nuk ka para të mjaftueshme. Përse nuk janë të mjaftueshme? Sepse ai, që na jep rrogën, nuk interesohet për këtë. Nuk na paguan për aq, sa e meritojmë, ndërkohë që meritojmë shumë. Meritoni shumë! Është shumë e rëndësishme të kuptoni atë, që kushdo mund ta bëjë këtë rrugë. N.q.s. duam jetë më të mirë për veten, gruan, fëmijët dhe prindërit tanë, atëhere do të dimë ta kryejmë këtë detyrë.

Unë e bëj këtë punë për arsyet e mëposhtme: që të bëj realitet qëllimin tim, dhe të siguroj për vete një jetë më të mirë, më të sigurt. Dhe kam edhe një arsye tjetër: nuk e di, se si jeni ju me atë, por unë për vete kam gabuar në jetë, dhe është e mundshme që nuk ka njeri që nuk e ka bërë këtë. Pra ndihmojini njerëzit të korrigjojnë gabimet, të rregullojnë mënyrën e jetesës dhe ta bëjnë më të mirë jetën e tyre! Ndoshta nuk janë edhe të gjitha gabime, por një pjesë e mirë e tyre fiton falje.

Mos u zemëroni me ata, të cilët ju ftuan, që t'ju prezantojnë FLP-n. Nuk ju gënjen: me këtë punë mund të siguron çdo gjë, që dëshironi, por vetëm se nuk jeni kuptuar me punën e deritanishme. Sistemi është i pabesueshëm - por duhet të pranoj, në fillim edhe unë nuk kisha besim. Tashmë shumë herë më kanë mashtruar; besoj se flokët e mi të thinjur flasin shumë për këtë. Kur hymë në Forever, besova gjithshka, dhe nuk gjeta asnjë hile. Absolutisht asgjë, nuk gjeta asnjë pikë të dobët apo asnjë mungesë, këtu me të vërtetë çdo gjë funksionon në mënyrë perfekte. Por unë prapë gjatë gjithë kohës mendoja, që duhet të ketë ndonjë kleçkë në këtë punë, firma me siguri e ka vështirësuar diku punën, që kriteret të mos kenë mundësi të realizohen me lehtësi. Por prapë e vendosëm, që të fillojmë punën, dhe pas disa muajsh u ngritëm në nivelin e menaxherit. Këtë punë mund ta bëjë çdokush, dhe kjo është shumë e rëndësishme. Po pse pikërisht Foreveri? Çfarë simbolizon për ne Foreveri dhe çfarë simbolizon për ju? Për disa problemin, sepse ju japin përparësi disa gjërave të tjera. Por nëse Foreveri simbolizon problemin, atëhere ai problem është me të vërtetë i madh!

Njerëzit pyesin shpesh: si ta fillojnë? Nuk kam mundësi ta bëj, nuk bëra shkollë, që ta kem rrogën 200 euro. Po ne prandaj e bëmë shkollën? që të kemi 300 apo 500 euro? Secili duhet të vendosë, do apo jo? Duhet gjetur "pjeja".

Prandaj jemi njerëz, që të jetojmë. Shumë veprojnë në atë mënyrë, sikur të kenë shumë jetë, dhe besojnë në atë, që ajo që pason do të jetë më e mirë... Ndërsa ka vetëm një jetë, nuk ka përsëritje.

Unë kam qënë dy herë milioner. Dy herë, dhe të dy herët kamë rënë përtokë. Bile edhe të shtrirë në tokë më shkelnin, që të zhytesha më thellë. Është turp të mos ngrihesh kur bie. Nuk ngrihet vetëm ai, që nuk ka ëndrra, nuk ka objektiva, nuk dëshiron jetën, ai që është dorëzuar.

Të jemi misionarë, të përhapim energjinë pozitive, t'ju çojmë njerëzve shpresën, sepse shumë vetë e dëshirojnë atë, vetëm nuk shikojnë rrugëdaljen. Ata jetojnë, si peshku pa ujë. Duhet tu tregojmë atyre rrugën, por edhe ne duhet të shikojmë. Nëse Foreveri ju ofron edhe juve edhe neve zgjidhje, kjo do të thotë që shikojmë rrugën e duhur. Këtë punë vetëm ata nuk dinë ta bëjnë, të cilët nuk kanë qëllime dhe ëndrra.

Askush nuk është fajtor, që lindin të varfër, sepse askush nuk mund ti zgjedhi prindërit. Faleminderit, që lindëm, që na rritën që të vegjël, na drejtuan në rrugën e jetës, na mësuan të jemi njerëz të mirë dhe të ndershëm. Por nëse do të vdesim të varfër, atëhere askush në botë nuk është fajtor, por vetë ne, sepse nuk luftuam. Foreveri krijon mundësi për realizimin e një jete më të mirë, vendimi varet vetëm prej nesh: a e shfrytëzojmë atë apo jo. Foreveri është vendi më i mirë, me qënë se këtu çdo gjë funksionon në mënyrë të përkryer. Mund të pohoj me guxim: ëndrrat simbolizojnë gjithshka në jetën tonë. Nëse duam të krijojmë biznes të mirë, nëse duam një jetë të mirë, është i nevojshëm entuziazmi. Duhet me qënë të hapur drejt njerëzve, dhe me qënë gati për të pranuar çdo lloj efektsh. E gjithë kjo do të ndodhi më vonë, në qoftë se kemi ëndrra.

FLP-ja është zgjidhje e mirë edhe për ata, të cilëve sot ju lulëzon biznesi, sepse gjithmonë duhet patur një alternativë rezervë. Sot, në shekullin e 21-të nuk është mjaft të merresh vetëm me një gjë, të jetosh vetëm me një version.

Në sheshin qendror në Bangkok rreth 40 vjet më parë ngritën një statujë prej betoni të Budës. Nuk është një krijim me vlera të veçanta artistike, por turistët pushojnë shpesh pranë saj. Një herë një prifti budist menjëherë i lindi një ide, që statujën duhet ta merrnin në tempull, dhe për këtë morri vinç dhe njerëz. Gjatë transportit betoni në një vend u plasarit pak, për të cilën nuk u preokupua njeri, kështu më në fund statuja mbriti në tempull. Me kalimin e kohës plasaritja u zgjerua dhe u bë e dukëshme, që brenda saj ndriçon diçka. Priftit filloi ti interesoi kjo gjë, kështu më në fund thërriti njerëz, që të prishin cipën e betonit: së fundi

para tyre qëndronte një statujë me ngjyrë floriri, e cila më parë në formë betoni qëndronte pa vlerë në sheshin e Bankokut.

Disa prej nesh nga brenda janë florinj, vetëm se duhet të heqim prej saj lëkurën. Ta shpartallojmë atë beton! Ne na betonuan të tjerët. Të tjerët na thanë, që duhet të përfundojmë shkollën, duhet të futemi në punë dhe të punojmë 45 vjet, që më pas duke kaluar në pension të mos plotësojmë dot as gjërat më themelore. Të mbledhim ngjitësin, të heqim nga veshët dyllin, të hapim mendjen, sepse kjo kohë është koha e mundësive.

Shumica e njerëzve të suksesshëm në kohën tonë janë të marketingut me rrjet. Në 10 vjetët e ardhëshme 80 përqind e milionerëve në botë do të dalin nga këtej. Në lidhje me punën tonë problemi i vetëm dhe më i madh është, që nuk kemi shef, dhe nuk ka njeri, që të na stimulojë për punë. Ne duhet ta gjejmë vet nxitjen, në zemrën tonë. Shumë njerëz sot ulen atje përpara televizorit, ndrojnë stacionet dhe nervozohen. Duhet vështruar, të dëgjojmë dhe shikojmë, se me çfarë merren njerëzit e suksesshëm, dhe ata duhet të ndjekim. A e dini se cili është ndryshimi midis njerëzve të suksesshëm dhe atyre të pa suksesshëm? Ndryshimi është i vogël: bëhet fjalë, se si e shfrytëzojnë kohën e tyre. Të pasuksesshmit janë skllëvër të kohës së tyre, dhe nuk e dinë, çfarë do bëjnë më pas në ditën tjetër.

Të suksesshmit e përdorin me zgjuarsiri kohën e tyre, dhe merren me gjërat e duhura. Gjeni disa njerëz, që duan më shumë, që dëshirojnë një jetë më të mirë, dhe ti ndihmojmë ata për ta arritur atë. Kjo është një punë e lehtë. Të zgjojmë ëndrrat, se janë përgjumur. Para kësaj njëherë duhet të zgjojmë ëndrrat tona, më parë duhet të ndizemi dhe të punojmë ne, për jetën tonë, për qëllimet tona. Më pas këtë dimë ta përsërisim edhe me të tjerët. Ne jemi transportuesit e shpresës dhe shëndetit. E gjithë kjo ndodhet në duart tona, dhe me këtë mund t'ju ndihmojmë shumë vetave.

Nuk linda për këtë botë, që të më mposhtin. Nuk jam dele, e cila pret, që ta shtyjë bariu. Jam luan! Jam shqiponjë! Shqiponjë, e cila mohon ecjen, bisedat, fjetjen bashkë me delet. Jam i vendosur deri sa të bëhem i suksesshëm! Jam i vendosur deri sa të bëhem i suksesshëm! Miqtë e mi, jini të vendosur për veten tuaj, për familjen tuaj, për miqtë tuaj! Kjo mund të realizohet! Pra le ta realizojmë!

Vitomir Nešić,
menaxher





JAM NË RRUGËN E DUHUR

ANNA FRANYÓ MENAXHERE

Menaxherja 37 vjeçare nga Budapesti, punon në një firmë ndërtimi, dhe zotëron disa diploma të arsimit të lartë.



Në ç'mënyrë dhe kur je lidhur me Foreverin?

Në 2009, nëpërmjet një shpallje në gazetë u njoha me këtë mundësi. Andrea Németh (më vonë sponsori im) më tregoi për këtë biznes. Më tha se çfarë duhet bërë. E prita me dyshim, se kjo do të mund të interesonte gjithkujt, por mendova, një provë sidoqoftë ia vlen ta bëj. I besova atij se kjo funksionon, megjithatë për vete mendoja se nuk do të shkoj as në një prezantim produktesh, pa forlur pastaj që më parë nuk kisha dëgjuar as për firmën as për produktet.

Si vazhduat më tej?

Andi filloi të punonte me mua, ndërsa unë përpiqesha të përvetsoja literaturën dhe materialet audiovizive të regjistruara dhe kjo vazhdoi disa muaj por vazhdon edhe sot.

Një pjesë kohe u angazhuat me njohuritë e ndërtimit të rrjetit dhe pjesën tjetër të kohës me produktet, po me ngritjen e skuadrës tënde a fillove?

Si jo. I thash vetes se në qoftë se e bëj siç thotë sponsori im dhe njerzit blejnë, atëhere kjo funksionon. Bëmë disa prezantime, ku pjesmarrësit i ftova për të mësuar. Për habinë time njerzit erdhën, blenë dhe u regjistruan.

Këto aktivitete të bindën vërtet?

Pata një problem me qenin, atë fillova ta „mjekoj“ me këto produkte. Qeni nuk gënjen, në qoftë se atij i bën mirë, atëhere nuk diskutohet. Këtu ndryshoi edhe qëndrimi im.. Për të lexuar e mësuar kam patur gjithmonë dëshirë, por më parë nuk kisha besim. Ndërsa duke filluar nga ky moment, besova se Foreveri është në gjendje të ndryshojë cilësinë e jetës, sin ë kuptimin material ashtu edhe në kuptime të tjera. U binda se vërtet mund të ndihmoj.

Si ndryshoi jeta jote?

Si e kujtëdo, në fillim edhe unë luftova vetë deri në fund me pengesat: u binda se nuk do të jetë patjetër mjedisi

im direkt që do të më pranojë me qejf për një aktivitet të tillë. Këtë e pashë me habi, mbasi më parë nuk kisha patur përvojë me shitjet MLM dhe nuk e dija që tek njerzit shumë herë ndesh me një rezistencë të fuqishme ndaj skemave të këtij lloji. Ndërtimin e biznesit e kuptova shpejt, edhe për produktet u binda, unë vet ndryshova nga vëzhgues i jashtëm në një vëzhgues i brendshëm. Në fillim nuk pajtoheshja me takimet e shpeshta, kur thoshin se duhet shkuar. Pastaj dalë e ngadalë u binda që çdo takim është edhe për mua, flet për mua prandaj tek të gjitha duhet të shkoj për veten time.

Nga regjistrimi fillestar deri sot kanë kaluar 3 vjet. Çfarë ndodhi me ty gjatë kësaj kohe?

Pata ulje ngritjet e mia. Mbeta në një nivel të ulët që nuk i përgjigjej perspektivës time. Nuk mora atë fitim as materialisht as shpirtërisht, që e pashë se në sistem ekziston. Nuk po kisha rezultate. Megjithatë isha aktive, nuk e ndërtova në mënyrë intensive biznesin tim. Pastaj Andrea Nagy nga linja poshtë meje „me llampën e besimit” më hapi sytë dhe më tha zgjohu. Pas një hezitimi të vogël, e futa në xhep egon. Pashë vullnetin e vaj dhe mu desh të vendosja se çfarë do të do të bëj: ose ta lë këtë biznes ose të ngrihem dhe të bëj diçka.

U bërë menaxhere, pra u ngrite në këmbë. Çfarë të çoi tek suksesi, çfarë tu desh të ndryshoje?

Fillova ta shikoj veten dhe biznesin nga një këndvështrim tjetër. Gjithshka e pashë nga perspektivë tjetër dhe me tjetër njësi matëse. Duke u kapur tek flokët e mij, siç kisha bërë shumë herë në jetë, dola nga moçali. Nga kjo filluan të më besonin edhe njerzit, u dhashë dhe mora prej tyre energji, gjë që më dha forcë se jam në rrugë të drejtë, të cilë e kisha kërkuar gjithmonë. Më parë isha shumë ironike, ku më lehtë komunikoj me qentë se sa me njerzit. Në mardhëniet me njerzit u zhvillova mjaft, po kështu ndryshoi edhe mënyra e të mednuarit për paratë.

Në ç'drejtim ecën rruga jote tani?

Në fillim të rrugës. Do të doja të jem shumë më e sigurtë, të mësoja më shumë. Nga pikpamja e biznesit shikoj nivelet e senior dhe soaring menaxherit, shikoj një biznes të qëndrueshëm, një biznes me të ardhura të mira, që ecën nën drejtimin tim, që ngrihet me mua dhe nuk mund të bëjë pa mua.

Me kë e ke ndërtuar?

Ata me të cilët punoj sot, nuk i kam njohur më parë, duke përjashtuar familjen time të ngushtë që tashmë më kanë mbështetur dhe ecin me mua.





NIVELIN E SOARING MENAXHERIT E ARRITI



György Csuka dhe Dr Ibolya Bagoly
(sponsor: Mihályné Nagy)

„Duhet të kesh besim tek vetvetja, ky është i gjithë sekreti”



NIVELIN E MENAXHERIT E ARRITËN



Sanja Balen dhe Davor Balen
(sponsor: Jasminka Petrović dhe Mirko Petrovic)

„Durimi është një mjet e madh për suksesin: në qoftë se troket gjatë dhe fort në një portë, me siguri do hysh brenda dhe do zgjosh dikë nga gjumi”



Csaba Borka dhe Anikó Lévai Borkáné
(sponsor: János Tóth)

„Herët e kemi filluar, tani ju rifutëm. Kurrë mos u dorëzoni; kurdoqoftë mund të rifillon!”



Ágnes Csiha dhe Norbert Dézsi
(sponsor: Dr Edit Révész Siklósné dhe Zoltán Siklós)

„Faleminderit FLP-së që më në fund mundëm të hedhim bazat e të ardhmes sonë!”



Ilona Dánku dhe Mihály Dánku
(sponsor: György Csuka dhe Dr. Ibolya Bagoly)

„Ndihamoni të të tjerët që të ndihmoni veten”



Dr Judit Kolonics
(sponsor: Dr Edit Prókay dhe Dr József Lipták)

„Nuk dorëzohem, mbasi gjithnjë duhet luftuar”



Ilona Kreicsik
(sponsor: Imre Meggyesi dhe Tamara Kántor Meggyesiné)

„Mos puno për jetën tënde, por në jetën tënde!”



BASHKË NË RRUGËN E SUKSESIT

Lászlóné Pintér dhe László Pintér
(sponsori: Tünde Göncz)



„Në qoftë se dikush ecën me durim drejt
endërrave të tij, dhe dëshiron të bëjë atë jetë
që ka imagjinuar, një ditë papritur takohet me
suksesin.”

Henry David Thoreau



NIVELIN E ASSISTANT MANAGER-IT E ARRITËN

Bajkánné Vitéz Krisztina
& Bajkán Zoltán
Berényi Pál
& Kovács Éva
Dr. Medgyesiné dr. Gesztesi
Stefánia & Dr. Medgyesi János
András
Dr. Mendege Dóra
Fülöp Valéria
Lorena Gvačić
Horváthné Zsibók Erika
& Horváth János
Kardos Eszter Éva
Nela Makšić
& Aleksandar Makšić
Molnár Rudolf Ildikó
Laszlo Pasko

Paskó Csaba
Patkós Edina Anna
Suzana Petrović
Slavica Stevanović
Tengerdi Gábor
& Kádas Krisztina



NIVELIN E SUPERVISOR-I E ARRITËN

Árva Zoltán
Balogh Zsigmond
Balogh János
Marija Bančov
& Mikloš Bančov
Borbola László
Vesna Cancar
& Dalibor Cancar

Lidija Čovran
Csizmadia Róbert
& Porubszky Marianna
Dinnyés Nóra
Marija Đoković
Andreja Đoković
Novak Filipović
Fitos Józsefné
& Fitos József
Fülöp József
& Fülöp Józsefné
Iván Szilvia
Martina Jerina
Király Antalné
Kiss Attila
Kovács Csaba
& Brugós Denisa
Lehoczky Enikő
Lele Róbert
Lendvay Péterné

& Lendvay Péter
Marija Lukić
Milena Lukić
Márton Éva
& Márton Antal
Magyari Szilvia
Dejan Marcelja
Aleksandar Milešević
Julijana Peso
Milan Repac
& Stana Repac
Tatjana Robić
Szénási Zoltán
& Szántó Mária
Szegeginé Németh
Judit
Tapaszi Zsuzsanna
& Hartó István
Tóth Máté
& Bognár Beatrix



FITUESIT E PROGRAMIT MOTIVUES TË BLERJES SË MAKINËS

NIVELI 1

Jožica Arbeiter &
Dr. Miran Arbeiter
Becz Zoltán
& Kenesei Zsuzsanna Viktória
Bruckner András
& Dr. Samu Terézia
Marija Buruš & Boško Buruš
**Csuka György &
Dr. Bagoly Ibolya**
Davis Erika & Davis Henry
Dr. Dósa Nikolett
Éliás Tibor
Fekete Zsolt & Ruskó Noémi
Olivia Gajdo
Gecse Andrea
Gombás Csilla Anita
& Gombás Attila
Gyurik Erzsébet & Sándor József
Hajcsik Tünde & Láng András
**Heinbach József
& Dr. Nika Erzsébet**
Hertelendy Klára
Illyés Ilona

Rinalda Iskra & Lučano Iskra
Dragana Janović & Miloš Janović
Juhász Csaba & Bezzeg Enikő
Sonja Jurović & Zlatko Jurović
Dr. Keresztényi Albert
Dr. Kiss Ferenc & Dr. Nagy Ida
Klaj Ágnes
Jadranka Kraljić-Pavletić
& Nenad Pavletić
Kúthi Szilárd
Lapicz Tibor
& Lapiczné Lenke Orsolya
Lipp Szilvia & Molnár Mihály
Mázás József
Dr. Molnár László
& Dr. Molnár-Stantić Branka
Muladi Annamária
Nagy Andrea
Nagy Ádám
& Nagyné Belényi Brigitta
Vaseliye Njegovanović
Dr. Marija Ratković
Dr. Rokony Adrienne
& Dr. Bánhegyi Péter

Sebők Judit
Senk Hajnalka
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin
& Dr. Seres Endre
Sulyok László
& Sulyokné Kökény Tünde
Dr. Surányi Katalin
& Gazdig Sándor
Dr. Szénai László
& Dr. Szénainé Kovács Gabriella
Varga Géza
& Vargáné Dr. Juronics Ilona
Varga Józsefné
Visnovszky Ramóna
& Bognár Gábor
Jozefa Zore
Zsidai Renáta

NIVELI 2

Haim Józsefné & Haim József
Kása István & Kása Istvánné
Dr. Németh Endre
& Lukácsi Ágnes
Orosházi Diána

Siklósné Dr. Révész Edit
& Siklós Zoltán
Tihomir Stilin & Maja Stilin
Utasi István & Utasi Anita

NIVELI 3

Berkics Miklós
Tomislav Brumec
& Andreja Brumec
Halmi István
& Halminé Mikola Rita
Herman Terézia
Krizsó Ágnes
Leveleki Zsolt
& Leveleki Anita
Stevan Lomjanski
& Veronika Lomjanski
Dr. Miliesz Sándor
Szabó József & Szabó Józsefné
Tóth Sándor & Vanya Edina
Vágási Aranka
& Kovács András
Varga Róbert
& Varga-Hortobágyi Tímea



PO TË MOS KISHTE PUNË,
ATËHERE NUK KISHTE
PARA. PO TË KISHTE PUNË,
ATËHERE KISHTE PARA,
POR NUK KISHTE LIRI.
PO TË MOS KISHE LIRI,
NUK KISHE SHËNDET -
GJITHMONË MUNGONTE
DIÇKA. MARIJA DHE BOŠKO
BURUŠ JA DINË PËR NDER
FOREVERIT, QË MË NË
FUND I KANË TË GJITHA
BASHKË. BASHKËBISEDUAM
ME MARIJAN PËR VITET E
SHKUARA.

Morrëm më shumë,

NGA SA EDHE KISHIM SHPRESUAR

MARIJA DHE BOŠKO BURUŠ SAFIR MENAXHERË

Sponsor: Veronika dhe Stevan Lomjanski

Linja e sipërme: Árpád Kisjakab, László Hári dhe Márta, Aranka Vágási dhe András Kovács, Miklós Berkics, József Szabó

Çifti nga Novi Sadi, Marija dhe Boško Buruš, prej katërmbëdhjet vjetësh janë antarë të Foreverit. Para saj kanë provuar shumë gjëra si sipërmarrësa, shpeshherë edhe në trekatër fusha njëherësh. Ndërsa Marija kishte me të vërtetë punë të mirë: për njëzet e shtatë vjetë ishte kryeinfermjere në një Qendër Shëndetsore. "Kur arrita në kulm, atëhere e lashë. Nuk kishte mundësi për tu zhvilluar më shumë, dhe përsëri... askush tjetër nuk do të hynte në vendin tim" - tregon ajo.

Por prapë përse e bëre?

Me Veronika Lomjanskin ishim shoqe dhe kolege edhe në një punë më të herëshme dhe gjithmonë e kemi kuptuar mirë njëra - tjetrën. Për tetë muaj kanë ardhur tek ne me Stevan, për të na mbushur mendjen. Folën pak për punën, më shumë u miqësua, sigurisht në fund e pranua, dhe do ti jem mirënjohëse për gjithë jetën time, që ishin aq të vendosur, dhe që në fund të fundit menduan për ne. Ndërsa për shumë kohë nuk na intereso i MLM-ja për shkak të eksperiencave të këqija që kishim patur më parë. Ndërsa produktet po, bile, pas një periudhe të shkurtër përdorimi edhe triumfuan. E vërteta është, që që në prezantimin e parë i bleva të gjitha, që më ofruan, nuk munda ti kundërshtoja.

Po ndërtimi i rrjetit...?

Ai nuk filloi rastësisht. Njerëzit e panë, që jam mirë, dhe pyesnin, çfarë ka ndodhur me mua. Ndërsa unë ju tregoja. Apo fillova të punoj, pa e ditur as vetë. Vetëm rekomandoja produktet, dhe filluan të ardhurat. Në muajin e parë u habita shumë për këtë.

Për atë, që pas punës së bërë merrje para?

Në atë, që kur ktheva një herë kokën mbrapa, dhe pashë, që shumë vetë qëndrojnë mbrapa meje. E bëmë biznesin, sepse deshëm të ndihmojmë njerëzit, por akoma nuk e dinim, që me këtë mund të fitoheshin kaq para, dhe që veç kësaj sa shumë gjëra mund të merrnim me programet promovuese. Thjesht më pëlqeu shumë niveli i menaxherit, si diçka e re, si sfida. E biseduam me sponsorin, se edhe çfarë duhet të bëjmë, që edhe ne të jemi menaxherë.

Çfarë ju tha Veronika?

Që të zgjerohemi. Ti fusim brenda njerëzit, me qënë se janë rreth nesh, dhe janë aktiv. Kështu ndodhi, që pas një pune prej dy muaj e gjysëm u bëmë menaxherë. Distiktivin e morrëm në të njëjtën kohë me dr. Marija Ratkovićin.

Në përgjithësi kjo u jep nxitje njerëzve. Edhe tek ju kjo ndodhi? Po, ndonëse jo menjëherë. Në atë kohë të gjithë mendonin, që tashmë fitojmë shumë në FLP, por kjo nuk funksionon kështu. Shumë pak punova drejt për së drejt, kështu që nuk pata pikë





të mjaftueshme. Në një seminar në Budapest, dëgjova, që në Europë askush nuk e ka arritur akoma pozicionin e njohur të menaxherit; më të shumtët dorëzohen. Unë këtë gjë nuk e kam dashur asnjëherë, gjithmonë e kaloj murin tej për tej. Me bashkëshortin vendosëm, që ne do të jemi ata, që do të shkojnë deri në fund të rrugës, dhe tre muaj pas marrjes së vendimit, përsëri arritëm nivelin e menaxherit. Ja vlejti shumë. Brenda dy muajve u bëmë senior menaxherë, dhe u futëm edhe në programin nxitës për makinë. Ndërsa në 2001 e gjetëm veten në Super Rally-n në Kanada.

Kapërcim i madh. Në çfarë e ndjetë ndryshimin më të madh?

